

**VENDIM**  
**Nr. 366, datë 5.6.2024**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 645, DATË 3.8.2020, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR**  
**FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA**  
**(PALLAT) DHE NDËRTESAVE PUBLIKE, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM, NË**  
**NJËSITË ADMINISTRATIVE 4 E 8, ZONA ‘5 MAJI’, DHE NJËSINË**  
**ADMINISTRATIVE 6, ZONA ‘KOMBINAT’, BASHKIA TIRANË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 2.3, të vendimit nr. 645, datë 3.8.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.4, me këtë përmbajtje:

“2.4 Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, në masën 2 430 930 665 (dy miliardë e katërqind e tridhjetë milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe ndërtesave publike në zonat e reja për zhvillim, në njësitë administrative 4 e 8, zona “5 Maji”, dhe Njësinë Administrative 6, zona “Kombinat”, në Bashkinë Tiranë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar.”

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**